


BIBLIOTEKA  
SHTETIT



844-1-689/22

C 41

KRISTAQ CEPA  
(KAPA)





KRISTAQ CEPA (KAPA)

kratike Kapa denoncon kalbësirën e kohës. Ai nuk bën sulme sporadike, po të përsëritura, të dëndura. Poezitë e tij, ashtu si edhe të shumë autorëve të tjerrë përparimtarë të atyre viteve, ishin një sujm i vazhdueshëm ndaj pisllékut që kultivonte monarqia. Në një radhë me ta edhe KAPA, duke ruajtur origjinalitetin dhe individualitetin e tij krijues, vërvitet kundër deputetëve xhahilë e anadollakë, individualistë dhe antipatriotë, kundër parlamentit të dallkaukëve dhe gjumashëve, kundër pasanikëve kumarxhinch dëtregëtarëve zhvatës, kundër intelektualucëve kozmopolitë dhe idealizuesve të regjimit. Në poezitë e tij do të ndeshësh dendur aspekte realiste dhe të realizmit kritik të jetës aq të prapambetur të feudalëve injorantë dhe të borgjezisë që kolovitej sa në orientalizëm e oksidentalizëm. Nëpër këto tabllo vëren xvetënimin moral e politik të klasave të pasura «pa gajle, pa halle, të cilat kanë humbur çdo ideal përparimtar, majmunozen me snobizmin më të neveritshëm kozmopolit, bëjnë një jetë të përhumbur, kanë prerë çdo lidhje me popullin dhe vendin dhe po bastardohen me rrënjë e degë. Kapa na bën kështu të kuptojmë se në ato klasa, ku shuhet ideali, nis shthurja, atje ku mbaron patriotizmi fillon tradhëtia dhe atdhemohimi, atje ku shteti mbahet mbi këto klasa pa tjetër plakos mjerimi dhe tragjedia e popullit mbarë. Meritë e Kapës është pikërisht se në krijimet e tij më të mira, ai zbulon tragjikomedinë e kohës. Në njerën

anë — shëmtirën feudoborgjeze ndaj së cilës mban gjithmonë një qëndrim të prerë satirizues e përbuzës dhe, nga ana tjetër, ve gishtin tek plagët e rënda që këto klasa i kanë hapur kombit dhe masave punonjëse. Në këtë vështrim edhe poezia e Kapës ecën dora-dorës me ata shkrimtarë të tjerë satirikë që edhe godasin të keqen shoqërore, edhe tregojnë ç'mënxysra i shkakton ajo një populli. Pranë e pranë, ballazi njeratjetrës do të ndeshësh kështu në satirat e Kapës edhe feudalët e vonuar, borgjezinë kamatore me një këmbë në feudalisëm, edhe institucionet grabitëse të një shteti që thëthin gjakun dhe djersën e popullit, po, në anën tjetër, me dhëmbje të ndjerë dhe brejtëse edhe pasazhet që zbulojnë mjerimin fshatar e qytetar. Këto kontraste janë të dëndura. Në poezitë e Kapës lexuesi zbulon jo vetëm kontrastet ekonomike e shpirtërore që ka në klasat antagoniste, po edhe disa procese të rëndësishme të shoqërisë feudoborgjeze. Dallon menjëherë ujdinë e shtresës feudale me atë të borgjezisë, liberalizmin që po thëhinte borgjezia duke e inxhektuar në trupin e kombit. Po te poezia e tij dallon sado lehtë edhe lëvizjen ekonomike të klasave; koncentrimin e kapitaleve tregëtare, hajdutërinë e tokave nga borgjezia agrare, mikroborgjezinë që përpëlitet përpara kapitalit që majmet. Kapa dëshmon procesin e rëndësishëm se në vendin ku sundojnë marrdhëniet private mbi pronën, individualizmi ngrë krye, grykësia e fitimit bë-

het qëllim themelor. Vjershat e Kapës edhe pse ruajnë çdonjera idenë që shtron, kanë që të gjitha një unitet ideoestetik. Në disa vjersha e pasazhe ai shpreh edhe kufizime, sidomos kur është fjala për të treguar rrugëdaljen shoqërore nga këto fatkeqësi, mendime iluministe, frysme reformiste. Po nuk është kjo esenca e tij. Kapa qëllon shtetin që përmes ligjeve xhvatore dhe përbartuesve shpirtkazëm shkaterron masën fshatare: «me senet në dorë, në prokurori, — Dhe ia merr të gjitha: shtëpi, ara, dhi». Po është kuptimplotë se në këtë mjerim ekonomik masiv që sjell hajdutëria e klasave shfrytëzuese dhe shteti që kanë në dorë, klasat e shfrytëzuara nuk dorëzohen. Ato janë të forta, mjerimi i pjek, i bën të kuptojnë edhe më mirë shtetin dhe klasat që e drejttonin atë. Është edhe kjo arësyjeja që, në disa poezi të tij, autori na jep tensionin e tronditur të klasave të pasura, që nuk e dinë se do ta mbajnë dot paranë, tek ai do të ndeshim edhe ligshtinë e shtetit që kanë në dorë po edhe vitalitetin e popullit punëtor që e ka «syrin tek e ardhmja» dhe, megjithse është tërë mungesa, ka një vitalitet historik: «banesë kasollen, pa rroba në trup — dhe je i fuqishëm, mban botën në sup...»

Poet thallisht politik, tërë probleme sociale, tërë ironi dhe sarkazëm popullore ndaj shfrytëzuese, Kapa është njëkohësisht shumë komunikues për shtresat e gjera të popullit. Satira e tij ruan dhe

*zhvillon disa nga anët më të mira të poezisë satirike  
të traditës sonë, ajo është një poezi tepër vizuale, që  
të lejon menjëherë të parafytyrosh kohën dhe ambi-  
entet, një poezi pa lajle-lule, po tokësore, plot detaje  
realiste, si ato pemët që janë të rënduara mirë nga  
frytet.*

ADRIATIK KALLULLI

Korrik-Gusht 1975

## MAJESTIK' I KORÇËS<sup>(1)</sup>

Majestik' i Korçës, një kafe në pjacë,  
Venë shkojnë kohën, kur s'dalin sullacë,<sup>2)</sup>  
Një pjesë e rinisë, një pjesë zyrtarë.  
Do t'ju them ç'dëgjova, do t'ju them ç'kam parë:

Që kur hyn te dera e gjer te bufeja  
Plot klient' ësht' mbushur, s'ka ku hidhet veja;  
Ca lozin, ca flasin, ca qërojn' hesapin,  
Të gjithë sa venë «purbua»<sup>3)</sup> nuk japid.

Në tryezën ngjitur rrin' ca pasanikë,  
Që kur ngjau një vrasje u ka hyr' një frikë,

---

1) *Majestiku*» në vitet '30 ishte kafeneja më e dëgjuar e Korçës. Aty mblidhej «ajka» e feudo-borgjezisë.

2) *Shëtitje*

3) *Bakshish kamarijerit*

Sa s'din' ku tē fshihen, ku t'i ven' paratë,  
Cdo çoban, kur shohin, trëmben, u ven' shtatë,

Një tufë djemosha xholit ia kan' shtruar,  
Dhe disa prej tyre janë tē martuar.  
Vazhdon lodra natën, njërin bëjnë arkë,  
Harrojnë se gratë i presin pér darkë.

Katër në tryezë janë veshur shik,  
Po lozin një poker aristokratik:  
«Dy per» i thot' njëri, tjetri thotë «flossh»,<sup>1)</sup>  
Të tjerët nuk flasin, kanë letrat bosh.

Ja, ca djem tē rinj pa qime në faqe,  
Pan' se vura veshin, qëndruan sa kaqe:  
Njëri ka një jetër, që ia paska shkruar  
Një vajz' e qytetit, q'e pat dashuruar.

Ca pa lesh në kokë flasin politikë;  
C'bëhet në Evropë, c'bëhet n'Amerikë,  
Si qëndron sot Franca kundrejt Gjermanisë  
Dhe në plastë lufta pér shkak t'Japonisë.

---

1) «Dy per» e «flossh», kombinime letrash në poker.

Tre në një tryezë duhan' ndes e shuaj,  
Nuk janë korçarë, po janë të huaj;  
Habitën për luksin, se e shkon Parisë...  
Dhe ankohen bota, thonë: «kemi krizë!»

Një me bark të gjerë po flet për qamet,  
U tregon gjith miqve se kish një senet,  
Kish lëshuar t'holla me fajde pa masë,  
Dhe do t'merrte shpira me an' të davasë.

Ca flasin për gjuhë dhe ca për muzikë,  
Dhe disa të tjерë kanë hall për prikë,  
Ca avukatllëke, ca për mjekësinë  
Dhe një s'bënte fjalë, veç për historinë.

... Majestik' i Korçës, kafe mbi kafetë,  
Sa rri në tryezë, garsoni vjen vetë,  
Mbushur plot me njerëz dhe gjer te bufeja,  
Ju lutem më falni, se m'u ftoh kafeja.

*Botuar në revistën «Rilindja»  
Korçë, Viti I, nr. k, datë 28.11.1934*

## QYTET I KONTRASTIT

Kjo Tiran' e kuqe rrugët me pllakaqe<sup>1)</sup>  
Vete kërkon punë si çupa, si djali;  
Kjo Tiran' e kuqe në një rrëzë mali,  
I përngjet mësallës, q'është me dy faqe.  
Ç'të kërkosh gjen brenda, të gjitha jan' boll,  
Her' je në Paris, her' je n'Anadoll<sup>2)</sup>).  
Diku po na vajtka me makin' një zonjë,  
Po na vjen dhe gega myshterinj' të ftojë,  
Se s'i shkon salepi, nuk i shitet boza...  
Pjacës ca zonjushe kan' dal' t'marrin poza.  
Aty të sheh syri gratë elegante,  
Veshur sipas modhës me duart me gante<sup>3)</sup>),  
Këpucë nazike, çantën nën sqetull,  
Tunden, kapardisen, t'marrin gjak në vetull.

---

1) pilaka.

2) E ka fjalën për veshjen, për paraqitjen e njerëzvet.  
Nga njana anë njerës të veshun, sipas modës së fundit (si  
në Paris), nga ana tjetër njerës të veshun, si në kohë të  
Turqisë.

3) dorashka.

Por sheh dhe të tjera veshur me çarçaf,  
Mbuluar dhe kokën, q'e habit tuafë;  
Në vend të këpucës nallanat heq zvarrë,  
Me një sy sheh rrugën, kur gjezdis pazarë.  
Shih kostumi i burrit me stof' inglizi  
Dhe bastun në dorë, ka marraz Parisi;  
Kostume të ndryshme, modhe tyrlish modhë,  
Ca të hekurosur dhe ca siç u ndodhë:  
Xhaketë stolisur plot me thekë-thekë  
Dhe për pantallona veshur benevrekë;  
Ca qylaf në kokë, disa me bombera,  
Ca dalin pa shapkë dhe ca me berera,  
Ca, në vend të shapkës, lidhin një shami,  
Plot qostekë gjoksin, kobure dy-tri.<sup>1)</sup>  
Çdo kostum të duash e gjen në Tiranë  
Dhe në daç t'i shkruash nuk ia del dot mbanë.  
Gjithë tyrli gjuhësh dëgjon për minutë,  
Gjen nga gjithë kombet, përvëçse çifutë.  
Një lëvizje e madhe, kryeqytet i thonë,  
Sa dot s'e merr vesh as qeni të zonë,  
Ca venë e ca vinë, një kallaballëk,  
Hotel' e kafera aty jan' bollëk.  
Kush shkon në kafe, që të pij' një kupë,  
Rri atje ku ndodhet, si garson një çupë;

---

1) Bajraktarë, feudalë, njerëz të regjimit, që kapardiseshin e parandonin nëpër kryeqytet.

«Helbete, të thotë, ka lezetn' e saj,  
Kur servir zonjusha kafe ose çaj...<sup>1)</sup>

Këtu këtjé në fushë ngrehur ca pallate  
Binara të reja me tri-katër kate  
Hallbu nuk kalohet, se ka balt' e lucë,  
Kush kalon s'andezmi mbetet pa këpucë...  
Në Tiranën tonë, në kryeqytet,  
Veç me sinemara zbavitet mileti;  
Në vend të baletës, aty jan' çengitë,  
Që u heqin mërzinë, nata u bëhet ditë,  
Dhe kshtu kalon koha, gjer n'orët e para.  
Pastaj, për të fjetur ësht' hotel «Ferrara».<sup>2)</sup>

*Botuar në revistën «Rilindja», Korçë,  
Viti I, nr. 2 15 dhjetor 1934.*

---

1) Aluzion për kafe «Kursalin», një ndër qendrat më të mëdha të korruptionit e të zvetërimit n'ato vite.

2) Më tepër se hotel, një shtëpi publike ku katandisej elita feudoborgjeze.

## Q'NA SJELL 35-a

Mbaroi vit' i vjetër, erdhi vit' i ri,  
Aj të shohim fatin, si unë, si ti,  
Nuk do t'ndaj peshqeshe sikur ësht' zakoni,  
Mos ju mbetet hatri, mos u zëmëroni.  
Do t'hedh fall me letra ç'do na sjell moti,  
Do flas si profitët, jo fjalë së koti,  
Do ju them kësметnë për tridhjetepesën  
Pa hile në letrat ju them besa besën.  
Ja, i preva letrat, një fletë do t'heq;  
Tregon se u bëtë dhe një mot më pleq.  
Kjo tridhjetepesa është numër tek:  
Në një vend të botës do bëhet dyfek.<sup>1)</sup>  
Do kërleshen popuj, do pëlcasë topi,  
Gjithë municionet do t'i japë Evropi,  
Nëpër gjith' Evropën do ket' konferanca  
Të mos mbajnë armë, të përhapet shkenca,  
Të mos bëhet lufta me mijete barbare,

11754

1) Në këtë vit, më 1935, Itali ja fashiste do të sulmonte Abisininë.



Ja luftë kimike, ja mos bëhet fare.  
Franca do jet' Francë, gjermani gjerman...  
Zor të bëjnë luftë asnjerit s'ia mban.  
Një ballon do ngjitet përmi stratosferë,  
Një njeri nga hëna mbi tokë do t'bjerë  
Për të rregulluar krizën dhe buxhetet,  
Se përndryshe s'dilet, zor e kanë shtetet.(!)  
Thuhet se këte vit na vjen superkriza  
Dhe kshtu gjith beharë nuk do t'kemi miza...  
Ata që do t'sëmuren do t'marrin doktorë  
Dhe këta nga dollari nuk do t'heqin dorë;  
Kush me veresie ilaçe do t'marrë  
I sigurt të jetë vetë e bëri varrë...  
Më tregojnë letrat se pun' e fajdesë  
(Megjithëse këtyre nuk u jepet besë)  
Do të jetë e pakë, jo si gjer tani,  
Borxhet do të falen që nga Vit' i Ri!...

. . . . .

Po dhe sa për modhën, zonjusha, dëgjoni:  
Ta nisim me radhë, nga kombinezoni:  
Ky s'do ket' ndryshime, vetëm se fustani  
Do ndryshojë shumë, jo si ky që mbani.  
Do bëhet m'i gjatë, dekollte i hapur,  
Me një rryp të hollë në sup do jet' kapur;  
Kapella do t'jetë... s'di dhe un' se si,  
Herë si tenxhere, herë si tepsi;

Për tridhjetepesën çorape s'do t'ketë  
Dhe thonjtë do mbahen shumë më të gjatë;  
Të kuqt' e të bardhët do t'jet' me dyzina,  
Nuk do t'duki njerëz, porse figurina...

Me që do të jenë t'rralla napolonat,  
Do t'bëhen të ngushta shumë pantallonat.  
Sa na shtohet kriza, aq më shumë kumari,  
Lohen napolona, lohen franga ari;  
Njëri shkon i lumtur, i ndihmoi fati,  
Tjetri, veç parave, humbi dhe... sahatin.  
Gjat' tridhjetepesës do t'bëhet çudi:  
Dhëndëri me vjehrrën do t'zën' dashuri.  
Sinemat do sjellin filma kolosalë  
Me skena luksoze, supernatyralë;  
Këmbë sa të duash, gra siç i lind nëna,  
Yj nga më të mirët, nga qielli të rëna.<sup>1)</sup>  
Dhe studentët tanë do t'martohen jashtë,<sup>2)</sup>  
Qoftë dhe familja dhe shteti mos dashtë...

*Botuar në revistën «Rilindja» Korçë  
Viti I, nr. 3, datë 1 Janar 1935.*

1) «Yjet» e kinematografisë.

2) Aludim për mundësitë e krijuara të korruptionit të jashtëm borgjez.

## C' D E S H A T' I S H A

Sikur t'na e linte Zoti ne në dorë,  
Siç ua pat lënë disave shenjtorë,  
Dhe të zgjidhnik vetë t'bënim si të donim,  
Besonj se në botë t'lumtur do të rronim....

...Dhe sikur pas meje t'vente gjith mileti  
Dhe të merrja vota sa ç'merr deputeti,  
Këtë gjë s'do ta doja, s'do t'kisha dëshirë,  
Pa s'ka gjë se rroga ësht' goxha e mirë.  
Çifligje nuk doja, as titull pasha,  
Efendi, aga, nuk i kam sevda.  
Shkrimtar s'do m'pëlqente, as edhe historian,  
Të punoj me mëndje, ose me çekan;  
As sheqer mos shisja, as malifaturë;  
Këpucë mos bëja, mos mbaja as furrë;  
Tregëti mos bëja, mos isha sarraf;  
As me qehallarë dhe bej me taraf;  
Hoxhë s'më pëlqente, por as prift me rrasë,

Që t'i bëja lutjet me barr' e me thasë.  
Fajdexhi mos isha në fundin e herës,  
Moratoriumi ësht' në prag të derës;  
Gjeneral nuk desha, oficer me pallë,  
Merr nishan në gjoks e një plumb në ballë...  
Desha t'isha grua... grua dhe jo tjetër,  
Por grua e re, jo grua e vjetër...

. . . . .

Me gjith' kto sa thashë, përsëri kam frikë:  
Ku do të gjeja burrë, po mos kisha prikë?  
Hej, lanet i qoftë, bota s'ka karar,  
Për gjërat e tjetrit bëhet tahmaqar;  
Të mira, të liga, të gjitha sa kam  
Do t'i mbaj për vete më mirë kështu siç jam.

*Botuar në revistën «Rilindja» Korçë,*

*Viti I, nr. 12, datë 18 maj 1935*

## PARADA E DASMËS

Seç po vjen një grumbull, gra e burra tok,  
S'ka ku hidhet molla, ku qëndron një zog,  
Gjith' ecin me hapa e dal' e ngadale,  
Vijnë bulevardit, rrugës principale.<sup>1)</sup>  
Vijnë si llazoret, vijnë palë-palë,  
Martojnë një çupë, martojnë një djalë,  
Kanë dalë rrugës, pjacës paradojnë,  
Duan që të duken, bota t'i shikojnë,  
Dhe qoshe më qoshe rendin njerëzia,  
Se kalon një dasmë, kjo është çudia.  
Rendin t'shohën nusen si po nusëron,  
Buqetën me lule, këpucët me fron,  
Kurorën me tela, prapa me duvak,  
Dhëndërin, q'e merr është djalë a plak...  
Tu-ru-ru gërneta, viu-viu violia,  
Nusja shkon me tempo, rrrotull njerëzia,  
Përqark me zonjushen njëra mban duvaknë,

---

1) Rrugës kryesore.

Dhe vllami pér krahу i tregon sokaknë.

Ja, disa nga krushkat kthehen e vështrojnë  
Dhe me zë të unjtër ven' e këshillojnë:  
«Ngre trupin moj nuse, bëju më të qeshur,  
Mos e thyen mezë, korsë pse s'ke veshur?»  
Dhe bylyku<sup>1)</sup> prapa me dhëndërin në mes,  
Dhe ky i krekosur porsi një këndes,  
Kumbaren ka pranë, po dhe plot të tjerë;  
Hidhet një nga djemtë: — Aj, t'ia marr nj'herë  
Këngë djalérie, këngë dashurie;  
Gjith' rrugës gërneta një avazi — i bie.  
Në mes të bylykut, ja dhe një uratë,  
Që t'u ver' kurorë më nga ora shtatë.  
Nusja me të bardha, dhëndëri me të zeza,  
Njeri si gallofi, tjetra porsi veza;  
Nusja ndrit si drita, si në fund dhe krye,  
U, lum kush e mori, se nuk u gënje,  
Dhe dhëndëri i zi si nata pa hënë,  
Si dhëndërit dhe nuses nur u paska rënë,  
Tualet' i nuses: bukuri e madhe,  
Syrin e ka pishë, qafën si sorkadhe,  
Kurorën mbi vetull, vellon e zvarosur,  
Gra e burra prapa vijnë e s'ka të sosur;  
Zonjat alla braca<sup>2)</sup>, vajzat angazhe,

---

1) Turma

2) Të kapura pér krahу.

Ndalet i habitur: «Kam dhëmbët e mia»;  
Shpejt dorën në gojë, që t'i konollojë  
Dhe vete t'i nxjerr, se më s'ka nevojë.  
Ç'do t'i dua? thotë: kaloi ajo kohë...  
Dhe në mos i paça, vall', kush do më njohë?  
**Po kur bën ta heqë dhëmbi s'çkulet lehtë,**  
**Dara heq pér poshtë, koka shkon përpjetë,**  
Dhe, i lebetitur nga dhëmbjet q'e zenë,  
Po s'e çkuli s'ndalet, se ia bëri benë;  
Barku thotë: «nxirret!», dhëmbi thotë: «s'dal!»  
... Ia bën qejfin barkut, dhëmbit nuk ia fal.  
Pa le t'ketë bukë, pa s'ka ç'i do dhëmbët,  
Siç nuk do këpucë pér të mbathur këmbët.  
Kur erdhi, me dhëmbët; — kur iku, pa dhëmbë,  
Vajti' e ardhje rrugën e bëri më këmbë,  
Pér çdo dhëmb nuk mori vetëm se tri franga:  
Kaq i blen sarrafi sa ç'i blen dhe banka.  
Do t'mos mibetet dhëmb, por as veth në vesh,  
Do t'kesh mall të zgjohesh, do t'kesh mall të  
gjesh.

Si nuk të sheh syri paren, që nuk vdes,  
Lirat e Turqisë, flori me këndez,  
Dhe gjerdhan' e gushës në gushën e çupës?  
Po tani sarrafi i mbledh e i.tret.  
Populli pér bukë, një nga një i shet.  
Unazat me gurë, qostekët me lira,  
Byzylykn' e dorës, vathët me inxhira

Dhe paran' e ballit të foshnjës motake,  
Erdhi koh' e keqe, jetë varfanjake,

Me sa mall i shkreti e me sa gëzim  
I dhuroi unazën nuses për kujtim!...  
Dhe tani nga gishti ia merr e ia shet:  
— Do kripë shtëpia, duhet bereqet!

Kush e bëri sefte, i ditur ka qenë,  
Që kurse ne dera reklamën ka vënë.  
I mblodhi të gjitha, dhëmbë dhe qostekë,  
Populli ia shiti vetëm për çyrekë.<sup>1)</sup>

...Ja dhe un' i shkreti kam një dhëmbë në gojë  
Dhe ia bëra benë. Kur të kem nevojë  
Do ta shkul pa tjetër; mir' po më kujtohet  
Sa vojta q'e vura; kurrë s'më harrohet...  
Kur më hiqte nervën e kur me ilaç...  
Ah! Saraf ç'më bëre, na, për atë paç!

Botuar në revistën «Rilindja» Korçë,  
Viti I, nr. 15, datë 6 korrik 1935

---

1) Vetëm për bukë.

## P A J A

Te një mik në dasmë më ftuan dhe mua...  
Ua paça borç, ua paça hua:  
Dhe desha nuk desha, gruaja më shtrëngoi  
Një peshqesh t'i shpiem, se prandaj na ftoi.  
Vetë nuk u ndodha, gruaja më tregoi,  
Q'i treguan pajën, kur vajti uroi:  
«Ç'të të them, or burrë, lum kush do ta marrë  
Pajën, që ka bërë; lë q'e ka me barrë,  
Po dhe çfarë pajel!... Ku mbaj mend dhe unë!...  
Çfarë s'kishte bërë!... Pastaj, çfarë punë!...  
E këto kuverta, kto «jiro» krevati,  
Kishte dhe qilime..., s'tregohet masllati.  
E këta jastekë: lloj-lloj, si t'i doje,  
Veç të ishe vetë, me sy t'i shikoje  
Pa le tapitarat, pa le kortinaqe!...

Sado të tregoj, do t'harroj dhe kaqe.  
Pa le vogëlima: këmish' e zhilera...

E këto «niktikora».., ku mbaj mënd e mjera,  
Me këto të qëndisur si në figurinë.  
Të gjitha me teste, po dhe me dyzinë.  
Dy, tri bizhamara i kish bër' tenekos  
Ç'të të them dhe unë!... Gjith' dyqan' i Shekos.  
— Po bono nuk kishte, as dyshek, moj grua?  
— Ç'të të them tashi, kur s'erdhe me mua!  
Kush e ze bononë, kush e ze dysheknë?  
Një maqinë vetëm nuk e ngre dot dengnë;  
Të shihje bononë, të merrte sevdaja,  
Pa le gardiropnë nga fundi në majë,  
Me këto pasqyra, me këto zografira...  
Besonj kish kushtuar përmbi dyzet lira.  
Të luan fiqiri' e ku numërohen?

Gjith' kjo pajë a jepet? Vallë, kush ka faj?  
A nuk ka faj çupa, nëna dhe babaj?  
I shkreti baba, jep para për ditë  
Të bëj çupa pajën, pa le pastaj prikë...  
Ç'duhet gjith' kjo pajë e gjith' ky masllat?  
Kush të ket' më shumë çupat vën inat.  
Çupat ven' inat e s'bëhen merak  
Se sot s'ka fitime dhe babaj u plak.  
Gjith' ditën i sheh qepin e qindisin,  
Disa bëjnë, jakë, disa zografisin,  
Më nuk lanë penjë, s'lanë umaira;  
Këto blihen me franga; prika ësht' me lira.

Çupa merr me vete, veç prikës dhe pajë,  
Ngarkohet maqina me kulm' e me majë,  
Me kulm e me majë te burri shgarkohet  
Njéri po shkatrrohet, tjetri pasurohet.  
Katr' a pesë çupa një shtëpi të ketë  
Vallë, sa pajë duhet?... Bëje hesap vetë...  
Lere pastaj prika, që duhet flori,  
Se, pa to, dhe çupën krype në shtëpi.  
...Prika është prikë..., pa le pastaj pajë...  
Ngarkohet maqina me kulm' e me majë,  
Ngarkohet maqina plot me punë dore...  
Sa vall' kushtoi çupa, nga shpia, q'e nxorre?...  
Prindërve të shkretë më s'u mbeten rupa:  
«Do qëruar plehu, do martuar çupa!»

*Botuar në revistën «Rilindja» Korçë,  
Viti I, Nr. 16, datë 20 korrik 1935*

MIHABET SOFATI

Po shetitnja rrugës si i dembelosur,  
Në çdo prak e portë gratë qen' radhosur...  
Plaka rri tjerr leshnë me furk' e me boshte.  
Nga kujtim' i jetës nuseve iu thoshte  
Si shkoi çüpërinë e si qe martuar;  
Sa vjet shkoi me burrën praknë s'kish kaluar.  
Vajzat i ven' veshin, qeshin, qesëndisin...  
Me këto llërë jashtë, me këta thonj me majë  
Qindisin e qepin, preqatitin pajë;  
Preqatitin pajë, borot plot i kanë,  
Po s'pat napolona, nuk ua kan' sevdanë.  
Kur mbaron së tjerri plaka mbështjell trembë,  
I ndihmon dhe vasha ndenjur këmb' mbi  
këmbë....

Fillon muhabeti për miq e për shoqe,  
Dje a qe në kishë, kë pe e kë poqe,  
Kush, vall', paska lindur dhe kush qenka vluar,  
Kush u nda nga burri dhe kush qe martuar,

Kush nuk shkon me vjehrrën dhe kush me  
kunanë

Dhe pas modhës fundit kush e kish fustanë...

— Ja, po vjen dhe Cilja nisur, pispilosur,

Të bardhën që bleu nuk e paska sosur,

I shkëlqen surrat, si një fletë kartë,

S'ka turp dhe del rrugës; duke gdhirë e martë

U kërlesh<sup>1</sup>) me burrin, sa u mblohd mëhallë:

Kërkonte kapellë,... s'i mjafton mësalla...

Veç, kur kalon rrugës një me zarzavate,

Kujtohet për darkë, ndryshe, shkoi e vate,

Do t'shpifte, do t'hoshte: «Të keqen, o burrë,

Sonte s'bëra gjellë, se kam qen' sëmurë.»

Kur bien kambanat për hesperinonë,

Plakat zën' e falen, nuseve iu thonë:

«Shko ndisni kandilë sa të mbanj' tër' natën,

Nesër kemi kremte, i paçim uratën.

.....

...Sa din' e sa njohin s'lënë pa ngojosur,<sup>2</sup>)

Ky lloj muhabeti kurrë s'ka të sosur...

Muhabet i ëmbël, muhabet sofati,

---

1) u zu.

2) pa marrë nëpër gojë, pa përfolë.

Goja s'u rresht kurrë, duart si sahati,  
Punojnë e nxitojnë në port' e në prangje,  
Gjith rrugët e Korçës me gra vargje-vargje.

*Botuar në revistën «Rilindja» Korçë,  
viti I, nr. 20 datë 21 shtator 1935*

## KATUNDARI NË PAZAR

Dhjetë orë larg, ngarkuar hajvanë,  
Po vjen katundari që të shesë kanë.  
Kush ka prishur pendën, kush sjell bëreqed,  
Kush vezët e pulat në pazar i shet,  
Kush një barrë dru, ngarkuar gomarë,  
Bën hesap t'i shesë dhe plaçka të marrë.

Pazar' i qytetit, pazar jahudiu,<sup>1)</sup>  
Që të gjithë blejnë veç te myshteriu,  
Ësht' mësuar këmba prej gjyshi, stërgjyshi:  
Ku ka lehur qeni, leh edhe këlyshi;  
Mirëpo tregtari s'ka din e iman,  
Kurse katundari ësht' m'allalexhan.<sup>2)</sup>  
Një killë bereqet ngarkuar gomarë,  
E shiti dhe misrin, q'i duhej për farë.

---

1) çifut.

2) pa të keq, i gjiltër.

Misri iu mbarua, si t'ia bënje hallë?...  
I vjen mendja rrotull, qylafi vërdallë,  
Dyqanxhiut i ka, beut ca më shumë,  
Po punon pa rreshtur, nuk mbyll sy për gjumë.  
Prapë nuk ia del dot, se sot ndryshoi jeta,  
S'të ngreh bujqësia, kjo ësht' e vërteta.

- Ngjatjeta, usta, e dyqan i mbarë...
- Mbarë paç, mirëse ardhtë, rrini, pashallarë;  
A jini? si jini? — thot' afendikoi,  
Dhe me nënëqeshje të gjith' i vështroi.
- Si i kini hankot bagëtin' e gjënë?  
Ç'na suallt' nga fshati gjësend për të ngrënë?  
Kush i ka sjell zoga, kush vezë, kush pemë....
- Këto janë peshqeshe, n'hesap nuk i zemë...:

Tregëtari ynë, çifut Selaniku,  
Bujkun, katundarë, e ropi, e fiku;  
Me disa pallavra, me disa betime,  
Ankohet e qahet se nuk ka fitime;  
Se ka veresie shumra për të mbledhur,  
Prandaj nuk jep më, që kur ia kan' hedhur;  
Fundja, dhe n'i dhëntë, i merr një senet,  
Q'ia bën shitkë arën, me gjithë bereqet.

M'ato pak të holla, nga plaçkat që shiti  
Nuk bleu as cereknë, nga ç'e porositi

Hankoja<sup>4)</sup> të blejë; nga t'ia mbanj' i shkreti,  
Kaç i bëri malli dhe kredi nuk gjeti.

— Shti i shkret' — i thotë dhe ia merr një herë,  
Kështu, duke kënduar, do t'harroj' qederë.  
Bar, elb e tershërë, kafshës nuk i vuri,  
Në mos ect' i mjeri, pastaj lot dhe druri;  
Samar në mos pastë, zbathur në u ndodh,  
Ky ka hall' e tij, s'pyet në u lodh...

• • • • • • • • : :

:::Kthehet me t'u ngrysur, me hejbe, me torba,  
S'merr asgjë prej gjëje q'i tha grua korba,  
Veç krip' e piper dhe një rotkë penj,  
S'di ç't'i thotë gruas e si ta gënjejë.  
Edhe, kur e pyesin: — Ç'kishte në pazar?  
— Ja, vajta me kal, erdha me gomar!»

*Botuar në revistën «Rilindja» Korçë,  
viti I, nr. 22, datë 19 tetor 1935*

---

1) Në kuptimin: gruaja.

## Ë N D Ë R R !

Pashë një ëndërr, sikur isha  
Deputet, cilindër kisha,  
Rëndësi të madhe mbaja,  
Dhe çdo ditë mirrja banja;  
Kur po vija n'Parlament  
Kishte mbetur veç një vend,  
Kur fillova të humbesha,  
Fët, u zgjova!... U, sa qesha!

Pashë një ëndërr, sikur isha,  
Deputet cilindër kisha  
Dhe kur ecja, ecja plogë:<sup>1)</sup>  
Po përse? Xhepat me rrögë  
S'më lejonin të nxitoja,  
Dhe, një mik, ku po kërkoja  
Disa fjalë do t'i thesha,  
Fët, u zgjova!... U sa qesha!

---

1) Plogësht, rëndë, ngadalë

Pashë një ëndërr, sikur isha  
Deputet, cilindër kisha,  
N'Parlament me vrap arrita  
Dhe një fjalë prebatita,  
Si baba i kombit q'isha,  
Herë rrija, herë ngrisha<sup>1</sup>)  
Kur m'i zgjuar po rrëfesha<sup>2</sup>)  
Fët, u zgjova!... U, sa qesha!

Pashë një ëndërr sikur isha  
Pasanik, pallate kisha,  
Shërbëtorë me dyzina,  
Me fabrika, me maqina...  
Dhe në rrugë kur kaloja  
Me nderonin, nuk nderoja,  
S'më mungonte çdo që desha,  
Fët, u zgjova... U, sa qesha!

Pashë një ëndërr sikur isha  
Dhe një titull bej e kisha,  
Një çiflik sa s'kish kufi,  
Unë e kisha me tapi....  
Bëja qejf e s'kish fre,

---

1) Ngrihesha

2) Po u tregoja

Shkoja jetën pa gajle,  
Vrisja prisja kë të desha,  
Fët, u zgjova!... U, sa qesha!

Pashë një ëndërr, sikur isha  
Fukara, para nuk kisha,  
Plot me halle me qedere,  
Kisha qe, po s'kisha qerre,  
Kisha arë, s'kisha farë,  
Dhe më vinte për të qarë,  
Dhe më qe mërziturjeta.  
Fët, u zgjova!... Ashtu mbeta.

*Botuar në revistën «Rilindja» Korçë,  
viti II, nr. 24-25, datë 28 nëtor 1935*

## **Q'TË FLAS**

Më kan' folur shumë, më kan' bër' taxhis  
Të mos flas për gruan, se më s'leverdis,  
Jo dhe daullka, që mban një avaz...  
Peqe, ja pushova, thuajm' ti ç'të flas?

Të flas punë feje?... Zoti mos e dhëntë,  
Veç të jem i marrë, t'nuë ken' lojtur mendë;  
Është «Hyll' i Dritës»<sup>1)</sup> gjithashtu dhe «Leka»<sup>2)</sup>,  
Prandaj mbi këtë çështje as fola, as preka.  
Të flas për xendarët?... Pupu! Meazallah,  
Në bëfsh ndonjë faj, ke të bësh me ta;  
Dhe për taksidarë kurrë nuk do t'flas,  
Se dhe ky xendarë gjithnjë e mban pas.  
Të flas për bakallë, që s'jep veresie?...  
Shih se mori vesh, më ngriti padie...

---

1, 2) Revista të klerit katolik të Shkodrës që mbanin anën  
më reaksionare e konservatore në atë kohë, kundër të cilave  
luftonte shtypi dhe shkrimitarët tanë përparimtarë.

Epo për furrxhinë thuajm' si të flas,  
Veç të rri pa bukë, të nxjerr një avaz...

Dhe për sinematë të duash të flaç:  
«Shko në të pëlqeftë; mos ec në mos daç.» —  
Kështu të përgjigjen, mund të ken' dhe hak,  
Pse i prish të hollat, kur nuk je merak?  
Po të flas për «Stamles-n», «Saiden», «Tomorë»<sup>1)</sup>  
Gjith' duhan' e vendit këta e kan' në dorë;  
Veç të lë duhanë, të mbytem në gjol,  
Cigaret e tyre janë monopol.  
Ashtu si për «Sita-n»<sup>2)</sup> fjalë s'mund të thuash,  
Se bukën pa kripë nuk mund ta gatuash.  
Po për elektriknë, që ndrit kasabanë,  
Si dhe për fabrikën, që ka atje pranë,  
Në bëftë gabime, prapë le t'i ujdisë,  
S'është puna ime, i përket Bashkisë.  
Dhe për birrën «Korça», birrë jo e lirë,  
Si ta zë në gojë, kur nuk e kam pirë?  
S'është për të folur, se mendjen ta humb...  
Pini që të gjithë, dehi, bëhi thumb.  
Të flas për revista, apo për gazeta,  
Se ç'kanë të mira, se ç'kanë të meta...

---

1) Shoqëri aksioniste duhani

2) Shoqëri aksioniste elektriku.

• • • • • • • • • • •  
Në thonjtë e ndonjerës shiko se po hyre,  
Të shajnë e të fëlliqin, kan' veglat e tyre.<sup>1)</sup>

...Dhe siç po e shihni, miq, hasmë, sa jini,  
Kur shahem më gruan, mëri mos më kini;  
Të shkruaj mbi punët, që ngjasin në botë,  
S'më duket e udhës, më duket e kotë.  
Të flas për të tjera më ven' në qymes:  
Un' e di proverbin: s'hyn prifti në thes.

)      *Botuar në revistën «Rilindja» Korçë,  
viti II nr. 24-25, datë 28 nëntor 1935.*

---

1) Aluzion për shtypin zyrtar e klerikal, që sulmonte shkrimtarët e publicistët e rinj përparimtarë.

## KANDIDAT PËR DEPUTET

Kam mbetur pa punë, vaj medet për mua!  
Po kam dhe familje, kam fëmijë e grua.  
Natën nuk kam gjumë, mendja m'vjen vërdallë,  
Nuk di nga t'ia mbaj e kujt t'i qaj hallë.  
E ç'zanat të zë?... Të gjithë s'punojnë...  
I ka kapur kriza, asgjë nuk fitojnë.  
Ç'zanat ësht' m'i mirë, vallë, kush e di,  
Që s'do kapitale, e s'do as mjeshtëri?...  
Veçse deputet, tjatër gjë nuk mbet  
Ngado t'i kthesh sytë të duket qamet.

S'ka si ky zanat asgjékund mbi dhe,  
E ke fjetur mendjen plot për katër vjet.  
Dhe në Parlament, po zure një fron,  
Del dhe tjetër herë, se bëhet zakon;  
Zori është sefte, sa të futësh këmbët,  
Rri, po fute këmbët, sa të bien dhëmbët.  
Dhe në thëng, zotrote, se ka punë shumë,

Kur flasin të tjerët flij, merrja me gjumë.  
N'u vëntë në votë, fundja më në fund,  
Shokut që ke pranë i thuaj: «më tund,  
Or koleg të lutem, pa, kur të flesh ti,  
Do t'të zgjoj dhe unë; se, sikundër e di,  
Dëgjoke, s'dëgjoke, kjo nuk ze mazi,  
Gjashtë muaj gjumë, gjashtë muaj rri...»

Në një shkollë nate që tanë u shkrova,  
Me korespondencë mësimet fillova  
Te universiteti i Deputetërisë  
Dhe t'i sjell shërbime atdheut, Shqipërisë.  
Për tre, katër muaj do t'marrë një diplomë,  
Siç marrin studentët në Paris, në Romë.

Kur të vijë koha, do bëj propagandë,  
Do t'marr një daulle, në mos gjeça bandë,  
Do t'mbaj dhe një fjalë përrpara miletit,  
T'u shpegoj mbi temën: «Vot e Deputetit»,  
Do t'nxjerr dhe gazetë, nga më të mëdhatë,  
Kur të vijë koha, do t'hap një fushatë,  
Se nuk ësht' e udhës, është një mëkat  
Të votojnë burrat, mos votojnë gratë.<sup>1)</sup>

---

1) Poeti tallet me deputetët zogistë, që në fjalimet e tyre para zgjedhjeve bëjnë premtimë «liberale» pér qëllime demagogjike.

Po kjo pun' e rrrogës s'para çon kandar,  
Se kjo èsht' e sigurt q'unë do ta marr;  
Dhe do t'ju jap fjalën e do t'ju bëj be:  
Do t'i ndaj në popull... me ca pak fajde.  
Pra, sikundr' e shihni, do bëj mjaft të mira,  
Të ma hidhni votën, n'u bëfshin të lira.  
S'jam sidokudo, as analfabet,  
Prandaj e vendosa të dal Deputet.

...Kisha një andrallë, isha në merak,  
Se isha pa punë, mbetur në sokak,  
Tani do t'ndjek shkollën, që nxjerr deputetë,  
Kur të vijë vjeshta, kandidat dhe vetë,  
Do më dalë emri shkruar me mellan,  
Për të gjithë botën zoti bën derman.

*Botuar në revistën «Rilindja» Korçë,  
viti II, nr. 31, datë 7 mars 1936.*

## KATUNDARI NË QYTET

Ngarkuar gomarë po vjen që nga fshati  
Dhe shportën me vezë dhe pula në pati,  
I sjell që t'i shesë një ditë pazari.  
Nuk ish as i fundit, nuk ish as i pari,  
Që s'kish dhe opinga, as gunë shajaku,  
Po vuan dhe djali, siç vojti dhe plaku.  
S'i mbeti gjë tjetër të shkretit fshatar.  
As kal e as mushkë, po veç një gomar,  
Dhe penda e qeve, edhe një dhi shytë,  
Prandaj po i ruan, siç ruan dy sytë.  
Kush, vallë, ia ka fajnë? As ky nuk e di,  
A, vall,' t'jenë njerëz, t'jetë perëndi?...  
Kshtu ish shkruar fati dhe nuk nxjerr as zë,  
E mban kokën ulur dhe nuk kërkon më.  
Kur ký, me gomarë dhe dalngadalë,  
E arriu qytetnë dhe atje u ndal.  
Pa njerëz të veshur: me rroba, këpucë...  
Sheh këmbët e tia... I kishte në lucë.  
Dhe tha me të drojtur: «Eh, atje u qoftë!

Sa tremben nga smundja; kështu njeriu mos  
rroftë.

Por pa dhe pallate me gurë, me bojë...  
E hoqi dhe pipën, që mbante në gojë  
E kujtoi kaliben pa oxhak, pa derë,  
Ku shiu dhe dëbora nuk e lën' të flerë...  
Dhe mbet i mahnitur... Kur një zë pa pritur.  
«Sa iu kërkon druve, apo i ke shitur?» —  
I thirri që prapa. — Jo, or zotëri,  
Tri lekë më dhanë..., në daç... merri ti.

. . . . .

Pa dhe djem të vegjël, një sa djalë i tia,  
Që vdiq atij moti, nga smundja... uria!  
Pa dhe kafenera, ku po pinin birrë  
E plot me mezera, qejf s'bëhej më mirë...  
Iu kujtua dasma, q'ishte bër' në fshat,  
Kur ngrinin dollira, pinin me inat.  
Pa dhe bukë furre... S'ish si buk' e tia;  
Kur e pa të ngrohtë, e mori uria;  
Nxori misërniken, që kishte në torbë,  
E kafshoi dhe tha: «Ah, moj botë korbë!...»  
Pa dhe magazetë me mall, ç'tyrlı malli:  
Ku gjëra për veshje, ku sende bakalli;  
Ky si mos më keq, gjysm' opinge mbathur,  
Dridhej nga të ftohtët, e po ecte zbathur,  
Kur ish plot këpucë dyqan' i esnafit...

Po, kur pa paratë në mostr' e sarrafit,  
U mahnit dhe tha: «Do t'vete t'i marr!»,  
Ktheu kryet prapa dhe pa një xhandar...  
Shpejt e mblođhi veten dhe shkoi te nallbati  
E mori gomarë... u nis për nga fshati.

*Botuar në revistën «Bota e Re» Korçë,  
viti I, nr. 1, datë 15 prill 1936.*

### EPITAFI I REVISTAVE

Doli 'i herë, në vaht — hile  
Me pak dritë si kandile  
Një revistë kulturale,  
Që përshkoi fusha dhe male,  
As xhenemi mos e qastë,  
Quhej «Flaga», ndjesë pastë!  
Nejse, shkoi, ashtu si shkoi,  
Me tre numëra mbaroi.  
Tha të pillte, po dështoi;  
La fëmijët nëpër udhë,  
Të parritur, si kërpudhë.

Doli «Jeta e kultura»,  
Kish të rinj e kishte burra,  
Gjith' të pjekur nëpër furra.  
Vdiq e mitur, e parritur,  
Veç tri numëra kish shitur.

Dhe, kur doli «ABC-eja»,  
Me lezet, si gratë e veja,  
Shpejt e shpejt e hop e hop  
Me një numër bëri stop.

Po «Rilindja» u përpoq,  
Më tridhjet' e dy... u doq.

. . . . .

*Botuar në revistën «Bota e Re» Korçë,  
viti I, nr. 2, datë 30 prill 1936, me pseu-  
donimin Ras-i*

## KUR TË HAHET HAKA

Sot jam i gëzuar, si do vetë zoti,<sup>1)</sup>  
Se puna që bëra s'më vajti së koti.  
Vërtet se harxhova dhe ca pak para,  
Po hakën e mora, fitova dava  
Dhe një batakciu, që desh më gënjeu,  
Një vendim i gjyqit gjith' shpresat ia preu.  
Ja, si qëndron puna, thoni se s'kam hakë:  
Kisha gjashtë muaj, q'isha në merak:  
S'ka njeri pa halle, vec zoti ia di,  
Kisha ca të holla, allten-parasi.  
Nuk dija ç't'i bëja, i dhash' me fajde  
Dhe t'isha i sigurt, mos kisha gajle,  
Ky m'i bëri shitkë shtëpi, ara, qe,  
Gjithë bagëtinë dhe më bëri be  
Nga njëqind q'i dhashë, këtu e motmot,  
Dyqind të më jepte... Po s'i bëri dot...

---

1) Vjersha është shkruar në formën e monologut të një fajdexhiu.

T'ia merrja të gjitha ç'kish e nuk kish!...  
Pa më dha dhe fjalën... asnjë dhjeç mos prish.

Shkoi gjysm' e vadesë, m'i pagoi njëqind,  
Ndërruam dhe senet e e bëm' dyqind...  
Nuk i pata faj, ah, e zëntë buka,  
Vajti mori mendje nga disa kopuka,  
Pa vjen e më thotë: «Dale-or zotëri,  
Gjysmat t'i pagova, c'të mbeta tani?»  
Të mirën q'i bëra aspak nuk ma di,  
Vjen e kundërshton, si një çilimi.  
Pa fjalët e tia i vanë së koti.  
Se unë ç'i bëra?... Me të shkuar moti,  
Me senet në dorë... në prokurori  
Dhe ia marr të gjitha: shtëpi, ara, dhi  
E ç'kish bagëti, — sikur qe seneti,  
E ta flaka jashtë: ishte vet' i teti!...

.....

...Mir' iu bë qafirit, atij batakciu,  
Ishte një gjakpirës, s'kishte shpirt njeriu,  
Desh të haj' paratë, ah, iu nxiftë nuri!  
Atë kokë pati, atë feste vuri!

*Botuar në revistën «Bota e Re» Korçë,  
viti I, nr. 3, datë 15 maj 1936.*

## PA GAJLE, PA HALLE

Parësi e vendit pa gajle, pa halle,  
Në sallë luksoze venë lozin valle,  
Venë lozin valle, zbaviten, dëfrejnë,  
Pa dhe botës tjetër vetë i rrëfejnë  
Si lohet tangoja, si lohet fokstroti,  
Jo më devolle, jo valle qëmoti,  
Si e mbërthen djali të bijën e botës;  
Të ngrihen përpjete dhe qimet e kokës.  
Ç'është politesa, ç'është etiketa,  
Si serviren pijet, kur ndodhen dy veta...  
Burrat në të zeza, gratë ngjyra-ngjyra,  
Si xhame kristali u shkëlqen fytyra.  
Me një vrap të gjithë: burra, gra e ç'janë,  
Vetëm të dëfrejnë, tjetër mendje s'kanë.  
— Ububu, sa bukur, sa lezet moj xhane,  
Kur këmbët e djalit pshtillen me fustane!...  
Dhe këta sazexhinctë, bijt e racës tjetër,  
E lanë mbasdore melodin' e vjetër,  
Por kohë më kohë ndërrojnë avas,

Herë ia marrin unjtër, herë e kthejnë xhas.  
Kur, të dehur, çiftet nuk gjejnë derman  
Shpejt dhe muzikantët e bëjnë duman.  
Kërcasin shamanjat, tapat në tavan...  
Ku je zengjinllëk, jetë pa katran!...

Patë, u kënaqtë, mjafit tanë dëfryet,  
Me aheng të kotë sytë i gënjet...  
Pa zbrisni nga kali, shihni atje tej  
Popullin, që vuan e që s'rron si bej.  
Ja mizat e dheut, shihni, o gjinkalla,  
Ai kërkon bukë, s'ngopet me përralla.  
S'ngjinjet as me afshin e tryezës suaj...  
Meqë s'ish në ballo, për ty ësht' i huaj...  
Jo, nuk ësht' i huaj, ësht' vëllai yt.  
Kur ti pi shamanjë, si vallë, s'të mbyt,  
Kur i bir' i botës me një rrëth fëmijë,  
Qan e lebetit dhe s'guxon të vijë  
Të të nderë dorën ty — një paralli,  
Që me djers' të tia ke vënë flori?...  
Po, kur mbushet kupa me vojtjet e tia,  
As nga ti s'do ndihmë, as nga perëndia...

. . . . . . . . . .

...Nejse, ç'ka të bëjë, bota kështu u end,  
Kush para na paska, paskërka dhe mend.  
Pra, le të dëfrejë dhe të hedhë valle  
Parësi e vendit pa gajle, pa halle!...

*Botuar në revistën «Bota e Re» Korçë,  
viti I, nr. 5, datë 15 qershori 1936*

## TITUJ FISNIKÉRIE

Nakatoset puna, përzihet mileti...  
Kujt i ra ndër mend dhe kush vallë e gjeti,  
Që ka shpikur tituj soji, mjeshterie?  
Apo mos ka qenë urdhër perëndie?...  
Titull, mor jahu, nuk ke se ç'i thua,  
Dhe s'ka qenë kurrë si ti e si mua.  
Kështu shquhet tjetri, si dhija nga dhentë,  
Se kandar nuk kemi të zigjasim mendtë...  
Porsi amëshori pa fre e pa shalë,  
Në çdo vend që ndodhet guxon e merr fjalë  
Dhe veprat e tia kanë plot sukses:  
E luajn' verdhushkat rolin në këtë mes!  
Shih, beu nga harbuti njihet jo më mirë;  
Njeri rron pa u lodhur, tjetri që pa gdhirë  
Vete lëron tokën e punon si derr  
Dhe hakën e tia kurrë nuk e merr.  
Dhe, në rast se ndodhet ndonjë kavaljer,  
Mos e prishni gjaknë, mos kini qeder,  
Se janë të rrallë, vetëm sa për mall,

Si gurë xhevahiri, që ndritin në zall.  
Rroba bën uratën, titulli njerinë,  
Në parat' e thata dallojnë sojlinë<sup>1)</sup>  
Siç dallohet plaku këmbëkryq në këndit,  
Koburja me sërmë bajraktar' i vendit  
Si beu, si arhondi,<sup>2)</sup> njëlloj e jo ndryshe,  
Ca gala, ca korba, asnijë dallëndyshe;  
Që të dy «të lodhur e të rraskapitur»,  
Me djersën e bujkut tokën kan' vaditur!

Çdo njeriu të pasur e që ka të holla,  
Në shtëpin' e tij' nuk i ngjiten njolla,  
Nuk i ngjiten njolla, jo, fisnikërisë,  
Të zi e ka gjaknë, si katrani pis.  
Pa dhe brez pas brezi dhe nip e stërnip  
E çmonte dhe shteti, e bënte qatip,  
Se një der' e madhe, një shtëpi oxhaku  
Lind dhe djem të ditur, si ç'ka qen' dhe plaku.  
S'ka si bëhet ndryshe, se i caktoi fati...  
Harbuti sojsës pëlqet nga inati;  
E ka kot, i shkreti, sojliu po sojli:  
Mëri mos ia kini, kaq bën e kaq di...

---

1) Njeriun e fismë

2) zotërinë

...Titujt, kur u ndanë, një pakicë zgjodhë,  
Shumic' e miletit atje nuk u ndodhë,  
Ca e blenë shtrenjt..., ca e ngjitnë vetë,  
S'është faj' i tyre, faji ësht' i shkretë.

*Botuar në revistën «Bota e Re» Korçë,  
viti I, nr. 6, 1 korrik 1936.*

### PËR SYT' E BOTËS

Bota ësht' e ndarë në meshkuj dhe femra,  
Dhe ndarjet e tjera kanë lloj lloj emra,  
Nuk ka kush të thotë se jan' barabar,  
Ja, dhe seksi seksit i ha në kandar...  
Të mos shkojmë tutje, flasim këtu ku jemi,  
Pasqyrën e jetës përpara e kemi:  
Shiko bulevardë duket një ujem,  
Me gra dhe me burra, me vajza, me djem.  
Kanë duf për qejfe, prirje për liri,  
Më nuk rrinë mbyllur, kyçur në shtëpi.  
Ahere dallon dy kampe të ndarë...  
Ku është zhvillimi, qëjeta ka marrë?  
Veç pak përparim në vatër, në shpi,  
Përjashta nga pragu asnijë shoqëri.  
Lluksi, tualeti të rren, të gabon,  
Se mendja dhejeta të vjetrat vazhdon.  
Gratë marrin poza, japid nënqeshje,  
Burrat mund të marrin nga një çmim në veshje,  
Dhe jo mië gjë tjetër... N'u hapt' bisedim

Femra e mbyll gojën, mashkulli më trim  
Shfaq ndonjë mendim. Po kur flasin modhë,<sup>1)</sup>  
Të lenë pa veshë, sa zonja q'u ndodhë.  
Kur qëllon biseda: Evropianizmë,  
Shpejt ta sjellin shembull gruan, si konizmë.  
Për emancipim s'u pëlqen mendimi,  
Se e marrin gruan veç si mjet dëfrimi.

...Ç'më gënjen mendja, deh, sa larg kalova  
Dhe jetën e sotme desh e kritikova...  
Harrrova i shkreti, sot s'jan barabar,  
As meshkujt e gjallë, as ata në varr,  
Kurse femrat tona janë shumë larg,  
Ndonëse shetitin rrugës varg e varg.  
Po, kur të vij' radha dhe për gjysmat tona,  
Do t'i bëjmë shoqe, s'i duam kokona!...

*Botuar në revistën «Bota e Re»,  
Korçë, viti I, nr. 8, datë 30 korrik 1936.*

---

1) Por kur flasin për modën.

## VRAHU DUHET HEDHUR

Muajt e beharit, e nxehta me saç,  
Piqet buka vetë dhe bëhet kulaç.  
Drapëri e kosa korrin e s'pushojnë,  
Me duaj kallinjtë në lëmenj i çojnë  
Dhe rreth strumbullarit kuajt me gulçim  
Shijnë bereqetin shpejt e me nxitim...  
Se, ja, po vjen beu, vjen afendikoi,  
Do hakën e tij, — o lum' e përroi, —  
Do hakën e tij, krejt bashin e grurit,  
Jepja, se s'i bihet dot me kokë murit...  
Mbushi ujë taze, preqatiti drekë,  
Ca vezë, ca zoga dhe dy-tre byrekë  
Se ka etje shumë, pa ka dhe uri  
Dhe ka prishur gjumin e mbi fshat u gdhi,  
Se sot shtrohet lëmi, se sot hidhet vrahу.  
— Puna e mbarë, o bujqër, eh! ju lumtë

krahu!...

— Mirseurdhërove «të paçim me jetë»,  
Që more zamet dhe u lodhe vetë.

Dhe me temenara dhe me politesë  
Të zotn' e çiflikut mundohet ta presë,  
Mundohet ta presë, për një i jep pesë,  
Se e flak dhe jashtë, pa e le të vdesë...,  
Puno pa pushuar, lëro e rrëmih,  
Me gra, me fëmijë, copëtoju, dërsi,  
Dhe fundi, së fundi ç'ke nxjerrë në shesh?  
Ha bukën pa kripë, për gjellë s'ke presh,  
Banesë kasollen, pa rroba në trup  
Dhe je i fuqishëm, mban botën në sup...

.....

...Muajt e beharit, e nxehta me saç,  
Qëndro pak në diell, në daç të pëlcaç;  
Po puna do bërë, vrahу duhet hedhur  
Dhe gjith' beregeti nga fusha do mbledhur.

*Botuar në revistën «Bota e Re»,  
Korçë, viti I, nr. 9, datë 15 gusht 1936.*

## TA GENJEJME VETEN

Bota u ndryshua, s'është si më parë,  
Do ndryshoj dhe unë, se mos vijë mbarë,  
Dhe sendeve t'gjalla, gjérave t'shtëpisë  
Do t'u vë ca emra, siç të leverdisë.  
Pos kësaj, t'u themi, hakën mos u hamë,  
Gomarit: *veshgjatë* dhe hankos: *madamë*;  
Kaliben me gardh, mbuluar me kashtë,  
Do ta quaj *vilë*, kush do hyj', në dashtë,  
Do të shohë mbrenda kandilen, që ndrit,  
Plakën e pangrënë, që në kënd dremit,  
Dhe, kur qëndron zgjuar, nuk ka hi në vatër,  
Mallëkon perëndinë pse punoi me hatër...  
Do t'i them rrogozit, jastekut me kashtë  
*Je krevat me susta, pështetje e mëndafshië.*  
Misrin e pagzova: një *kokërr-flori*,  
Piperë dhe kripën: *barut e inxhi...*  
Gunën... gunë s'kemi, as këpucë jo,  
Potinat e këmbët na u bën' shevrox;  
Në vend të këpucës, çdo muaj të stinës,

I mbajmë në këmbë rrotat e makinës.<sup>1)</sup>  
Rrotat e makinës, palltot askerie,  
Poture shajaku, çorape prej dhije,  
Kësulën më kokë dhe qesen në qafë,  
Çuditen dhe hallku, tmerohen sarafë,  
Se e ka japinë dyzet endezé...  
Mos pyet ç'ka brënda..., i numëro më nge.  
Sheqerin, kafenë, si lesht e devesë,<sup>2)</sup>  
Në katund s'i gjeni, dhe në vrafshi pesë!...  
Në mbeti gjësendi pa zënë në gojë,  
Le t'i verë një emër, gjithkush si të dojë.  
Fjala vjen, kopesë me dele, me dhi:  
*Kafshët e një cirku myllur në kuti.*  
Tamam kështu kan' mbetur, si lopët dhe qetë,  
Dhe pulat, këndezat: zogj, që rrin' mbi retë...

.....

Gjërat t'i ndryshojmë, emrat t'i këmbejmë,  
Si sytë dhe veshët sa mund t'i gënjejmë;  
Se ndryshe s'i delet, si arriu zamani;  
Filloni të qeshni, kur ju vjen të qani!...

*Botuar në revistën «Bota e Re»,  
Korçë, viti I, nr. 10, datë 30 gusht 1936.*

1) Opinga me gomë.

2) Ashtu si edhe leshin e devesë (që s'e gjenin).

## KANDIDAT PËR DEPUTET

Dikur ju kam thënë, popull e millet,  
Se dhe un' vendosa të dal deputet.  
Se dhe un' vendosa dhe i dhash' karar,  
Veç rrogës së Shtetit, tjetër gjë mos marr...  
Kur ta sjellë rastj, të ketë lezet,  
Të mos ju prish qejfin, pranoj dhe ryshfet...  
Andralla në paçi punëra në kini,  
Do t'caktoj orar në shtëpi të vini;  
Në sjellçi me vete dhe ndojë bakshish,  
Frikë të mos keni, se kjo nuk na prish.  
Por të mos gaboni, fjalë mos më thoni,  
Po s'dhat' nën dorë, punë nuk mbaroni,  
Jo se dua unë, por kështu ësht' zakoni:  
Çdo mendim paguhet, këte mos e harroni.  
Vetëm më jep votën, pastaj mendjen flije,  
Se un' jam pajisur me kultur' e dije  
Dhe kam rresht dy muaj që po praktikoj,  
Që gishtrinjt e dorës shpejt e shpejt t'i çoj,  
Ç'gjë të paraqitet të di ta votoj,

Zoti mos e dhëntë që ta kundërshtoj!...  
Një ish-deputet, po më jep «privat»<sup>1)</sup>  
Si duhet të sillem, fjalët si t'i mat  
Dhe ç'ilaç do t'marr të më zërë gjumi,  
Kur do bisedohet moratoriumi...<sup>2)</sup>  
Kam dhe një program, s'jam sidokudo,  
Pastaj, kam dëshiron shokët ashtu siç i do...  
Kur të vijë koha, ja ku lë një shteg  
Ta paraqit listën cilin kam koleg.  
Zanatin që zgjodha e kam për sevda,  
Kush nuk ma jep votën do t'jet' maskara  
Dhe, t'ju them të drejtën, t'ju kandis më mirë,  
Keni koh' akoma ta mblidhni fiqirë<sup>3)</sup>...  
Jo me fjalë boshe, jo llafe të kota,  
Por çdo gjë me rregull, të çuditet bota,  
Të çuditet bota, t'habitët mileti,  
Të gjith' të thërrasin: «Rroftë deputeti!»

\* \* \* \* \*

*Botuar në revistën «Bota e Re»,  
Korçë, viti I, nr. 11, datë 15 shtator 1936.*

---

1) Po më jep mësimë private.

2) Falja e borxheve.

3) Ta mblidhni mendjen

## INTERVISTË ME DOKTOR KAVALIERË

Dëgjoni, o popull, vini vesh milet,  
Ju të gjithë e njihni doktorë që flet,  
Se ky ka vendosur të dal' deputet,  
Dhe bota të prishet, të bëhet qamet.  
Me kavalierë që mban dekorata,  
Në kohën e fundit intervista pata.  
Fort i begenisur doktori bujar,  
Veç nga Ideali ka mbetur beqar.  
Ka vjetë i shkreti, që mundohet bosh,  
Vetëm se me fjalë nuk harxon një grosh.  
Kryetar «Opinge», shpirt aristokrati,  
Të gjithë e luftojnë vetëm nga inati...  
— Doktor i dëgjuar, më t'u shoftë nami,  
Mos të vdektë shpirti, mos t'u trettë dhjami,  
Më thoni, ju lutem, me ç'program do të vini,  
Si do të veproni, fuqi po të kini?  
(Dhe kavalieri, me fjalët e arta,  
M'i radhit të gjitha, siç i thotë karta):

- Të mirat e mia nuk maten me kut,  
Punët që do t'kryejë nuk do t'ken' hudut;<sup>1)</sup>  
Sefte bujqësinë, pastaj tregëtinë;<sup>2)</sup>  
Do t'i thaj dhe gjolet, do shtoj bagëtinë,  
Borxhet do të falen, siç thotë Soloni,  
Vetëm tetë orë ditën do t'punoni.  
Puna do të shtohet, rroga do t'madhohet,  
Do t'i ve në rregull, njeri mos ankohet.  
Dhe megjithkëtë nuk do t'kem mëshirë,  
Prandaj e theksoj, që ta dini mirë,  
Se me «pothen esqes» do ve një kontroll,  
Jo disa të vdesin, ca të kenë boll...  
— Tamam, ke të drejtë, po ç'ësht' e vërteta...  
— Lermë të mbaroj, more t'u ngjat'jeta,  
Un' e kam të gjithë popullin me vete,  
Punoj pér «Opingën» nuk punoj pér vete.  
— Po ti s'mban opinga, s'mban as fustanella...  
— Sot ka ardhur koha që ka nder kapella;  
Jam një liberal dhe pér feminizmë,  
E dua çdo punë oksidentalizmë.  
— Po...  
— Dale, prit, dëgjo, shëno:  
Do t'i ndjek senetet, do var fajdexhinjtë,  
Do t'i shtyp të vjetrit, do përkrah të rinjtë,

---

1) S'do të kenë kufi.

2) Së pari do të rregulloj bujqësinë e pastaj tregtinë.

Dhe shëndetësinë e kam për të bërë  
Të mos ketë vdekje pa koh' e pa sërë...  
— I vyer doktor, as aman një llaf,  
Folmë pak më shtruar, folmë si esnaf,  
Si do t'bëhet kriza...

— Kriza do t'varroset,  
Unë do t'përpinqem misri të mos soset,  
Hallku të punojë dhe të çallëtisë,  
Taksa të paguaj' sa t'i leverdisë...

...Edhe shum' të tjera, që më tha doktori,  
Desha që t'i shkruaj, vendi nuk m'i mori,  
Mbeta i mahnitur nga fjalët e zjarrita,  
Kot e akuzojnë: «I ka ment' e tharta!»

*Botuar në revistën «Bota e Re» Korçë,  
viti I, nr. 12, datë 13 shtator 1936.*

## TABLORA TË JETËS

Ja, dhe vjeshta, shok' e miq,  
U mbarua, shkoi e vdiq,  
U mbarua, shkoi e vate,  
Erdhi dimri me inate.  
Erdhi dimri me dëbora,  
Do ta zbardhë, ta bëj' fora...  
Kush ka pare, metelikë,  
Bën dhe pallto me kozhuk,  
Nga e ftohta nuk ka frikë.  
Mban dorashka me pambuk.  
E ka pupa, e ka pikë,  
Në gllanik zjarri vërge,  
Mbi këpucët mban llastikë  
Dhe çdo punë e ka më te.  
Zahire, ç'i deshi xhani,  
I ka blerë që vaft-ile,<sup>1)</sup>  
Gjellën taze nga tigani  
Ia bën hazër një kopile...

---

1) Që me kohë.

\* \* \*

Në një qosh me një shtëpi,  
Q'e mbulon një cop' çati,  
Nj'urë zjarri po tymos,  
Ca jetim' e një e ve,  
Hall' i tyre nuk u sos  
Dhe njeri nuk i ve re.  
Rroba s'kanë, cop' e trokë,  
Barkun bosh, si tambura,  
Për të gjith' punon një kokë,  
Duke lypur sadaka...<sup>1)</sup>

\* \* \*

Në katund, një bujk i ngratë  
Punoi tokën pa hile,  
Tash i ka hambaret thatë,  
As për kafshët zahire.

\* \* \*

*Botuar në revistën «Bota e Re» Korçë,  
viti I, nr. 16, datë 30 nëntor 1936.*

---

1) ndihma.

## PLAKU DHE I RIU

Ishte natë dimri... Natë, çfarë natë,  
Jo me kut e metro, me tërkuz' e gjatë;  
Dhe ne ishim mbledhur, bënim muhabet,  
Kish dhe nga të rinjtë, kish dhe burra pleq.  
Dhe kushdo dyzenit me avaz' e tia...  
Ja, disa mendime, që shprehte rinia:  
— E keqë kjo jetë, jallane dynjaja,  
Fryhet pasaniku, thahet fukaraja..  
Këto janë dy botë me gjëra të gjalla:  
Njëri e bën punën, tjetrit i pret palla.  
Një i falet zotit dhe tjetri parasë;  
Kush, vall', ka të drejtë e kush do t'humbasë?...  
Fund' i mesëlesë dhe fund' i belasë;  
Paraja shpalli luftë popullin të vrasë.  
Kur ballë për ballë u bëhet përpjekja:  
Njerit i qesh fati, tjetrit i qesh vdekja.  
Kështu ësht' e shkruar, kështu ësht' e thënë  
Thonë njerëzia, ata mëndjelenë...

Jo, nuk është fati... po je ti e unë,  
Që jemi verbuar e jemi për gjumë,  
Se nuk hedhim sytë të shohëm më tej  
Dhe ta gjejmë fatin, siç e ka çdo bej...  
Më s'na mban me shpresë jet' e amëshuar,  
Fund' i rruzullimit këtu duhet kërkuar.  
Në botën e vdekur, plot helme, siç rrojmë,  
Të shpallim të drejtën dhe jetën ta çmojmë;  
Se s'humbi gëzimi dhe shpresa e saj,  
Jo t'ia krisim kujes me lotë, me vaj...

Ndenjur pranë zjarrit, ulur pas oxhaku,  
Me çibuk në gojë, zu të flasë plaku:  
— Djemt e mi të dashur, djem si gjeraqinë,  
Rrofshi e gëzofshi, e shtofshi shtëpinë.  
Bosh që vrisni mendjen dhe flisni së koti,  
Po dëgjoni mua, se jam plak qëmoti:  
Kështu ka vajtur bota, një puno, një ha.  
Njëri lëron arat, tjetri bej, pasha,  
Me kalë me shalë, me shtëpi pallate,  
Me shkallë mermeri, la tri-katër kate;  
Plot me shërbëtorë, plot me qehallarë.  
Kur të vijë lëmi bereqet të marrë,  
Pula, vezë, shqerra e kësish vogëlime,  
Veç q'i do pa tjetër, po do dhe nderime.  
Po dhe temenara dhe sjellje të mira,

Se ka mall' e tia, e ka me tapira;  
E ka me të shkruar, me vula dovleti,  
Dhe ia din' të gjithë, pa ia di dhe shteti;  
Që kur u lind gjyshi, ia kish falur zoti,  
Që kur u nda toka.. prej shekujsh qëmoti!...  
...Ky qe bisedimi rrëth e qark gllanikut,  
Në një natë dimri, në shtëpin' e mikut,  
Dhe në mendjen time një pyetje mbiu:  
Kush kishte të drejtë: plaku a i riu?

*Botuar në revistën «Bota e Re» Korçë,  
viti I, nr. 2, datë 30 prill 1936.*

## PO KËRKOJ ILAÇ

Më zuri një sëmundje, fort u leqendisa,  
Dhe botën e tërë pér ilaç gjezdisa  
Vajta e ku s'vajta, e kë nuk pyeta,  
Ndonëse me halle, ésht' e dhemshur jeta.  
Pyeta një plakë, që kam në mëhallë,  
Tha: «Je ogradisur, paske shkelur djallë.»  
Dhe më nomatisi dhe më shoi thëngjij,  
Më bëri me kripë: «Bir, merak mos kij,  
Ti, në mos ke shkelur, ke këputur mish.»  
S'më bëri gjë plaka... Gjeta një dervish:  
— Ejvallah! — i thashë — jam në ditë halli!  
Dhe ky, anagjore: — Të ka zënë djalli...  
Fshtimu me këtë letër dhe thuaj u binde,  
Se ty, mor evlat, të kan' zënë xhinde.»  
Pyeta një hoxhë: — Hoxhë efendi,  
Të lutem, më thuaj ndonj' ilaç mos di,  
Se jam i pamundur e nuk kam fuqi... —  
Shpejt e nxjerr divitnë, më jep hajmali,

Po dhe hajmalia shkoi ashtu si shkoi,  
Dhe sëmundjen që pata, ma la, s'ma shëroi.  
Fundja, më së fundi, takoj një uratë:  
— As aman, o prift, se bëra mëkat,  
Nuk kam lënë hoxhë, s'kam lënë dervish,  
Vec tek ti kam shpresë, veç ti do ta dish  
Të ma shporrësh sëmundjen, që më shtin lëngatë  
Jam njeri me halle, bëfsh hair, uratë!»  
Urata i shenjtë me shtëllungën lesh:  
— Dëgjo, bir — më thotë — tjetër her' mos vesh  
Nëpër hoxhallarë, nëpër dervishlerë,  
Se ata të rjepin, un' kam çmim të prerë;  
Vetëm një dollar të mbarohet halli,  
Qofshin dhe kukunjtë,<sup>1)</sup> qoftë vetë djalli..»  
Iku dhe urata, punë s'më mbaroi  
Sëmundjen që kisha, as ky s'ma shëroi;  
Në gjithë vakëfet dërgova qirinj,  
U lava në jaze, fjeta në mullinj...  
Të gjitha i bëra, s'lashë gjë eksiq,<sup>2)</sup>  
**Sëmundja** s'më hiqet, më mundon, më vdiq...

Plaka nomatisi, dervishi më shkroi,  
Hoxha më dha nuskë, prifti më këndoi,

1) Kukudhët, lugetërit.

2) S'lashë gja pa bamë.

Cilido, pas qejfit, më ropi, më xhveshi,  
Mir' ma bënë, e desha, kështu pëson syleshi.  
Tani s'më ka mbetur tjetër për të bërë,  
E kam nisur punën me radhë, me sërë,  
T'i vete doktorit, të nxjerr një merak,  
Se humba fuqinë dhe mbeta pa gjak.

*Botuar në revistën «Bota e Re» Korçë,  
viti I, nr. 13 datë 15 tetor 1936.*

## **NE JEMI STUDENTË**

(*Këngë*)

Ne jemi studentë, jemi djem shkollarë  
Evropën e njohim botën kemi parë.  
Ne jemi të ditur se kemi studim  
Për danc edhe ballo kemi marr' mësim.  
Dimë ç'është moda, ç'është etiket  
Dhe si luhet valle-valle me dy vet'.

*Refreni:* Rroj më taksat e miletit  
              Jam student e jam i ri,  
              Anëtar i arkës shtetit  
              Prish para e bëj kërdi.

Dhe jetën luksoze jasht' e kemi parë  
Ne jemi studentë, jemi djem shkollarë.  
Kulturën me barrë, me thes e me kosh,

Të gjitha sa themi janë fjalë bosh.  
Vishemi siç duhet nuk kemi të sharë  
Supet plot me lecka, pantallonat zvarë.

*Refreni:* Rroj me taksat e miletit, etj.

---

(E pabotuar. Shkruar në vitin 1934, vënë në muzikë nga kompozitori Kristo Kono. Kënduar në një koncert dhënë në periudhën e viteve '30 nga «Shtëpia e Artit» dhe e ndaluar të këndohej në atë kohë. Këtu bëhet demaskimi i studentëve, djem të bezlerëve dhe pasanikëve — që vinin për studime me bursë jashtë shtetit dhe e kalonin kohën me dëfrime).

## TREGTARËT DHE FSHATARËT

Gjatë luftës tregtarët shpallën gara  
N'spekulime mos u delte kush përpara,  
Ngren' pallate dhe florinë grumbullojnë,  
Blen' çifliqe, po dhe depot i shumojnë,  
Ngjiten çmimet dhe i shpien lart, mbi retë.  
Bota vdiste që të rrojnë këta vetë.

Kur po ecin thumb të dehur me fitime,  
Dhe fshatarët zgjasin kryet për thërrime,  
Tregtarët zenë e qeshin, hargalisen:  
— Ç'janë këta që po kërkojnë të na bezdisin? —  
Porse turma luftëtare shkon përpjetë  
Edhe frenat e pushtetit i merr vetë.

Fillon pun' e rindërtimit me furi,  
Bëhen ligje dhe reforma pér çudi.

Tregtarët mledhin buzët, kuvendojnë,  
Fshehin mallë, pëshpërisin e përgjojnë...  
Kurse klasa punëtore shkon përpara  
Duke shkulur tërë gjëmbat që ka ara.

*Botuar në revistën «Hosteni» viti I.  
Nr. 11 dt. 14. 5. 1945*

V E S H M È V E S H

KARVANI ECËN — QENTË LEHIN

Rrini urtë djema, nuk bëhen shakara,  
Italis, Imperos, s'i del kush përpara.  
Ju me një dyfëçkë — ata gjylet okë,  
S'ke ç'i bën, e s'i bihet dhe malit me kokë.  
Pu-pu gjermanë, sakën se trazohi,  
Se u pret e zeza, u bën të pendohi.  
Shkoni me Mehdinë, ndiqeni Mithatnë  
Në doni të mirën, të gjeni rehat'në...

Erdhë partizanët? — Të shpejta i kanë.  
S'rindërtohet vendi po s'pate paranë?  
Ç'duhet ushtëria, lufta tash mbaroi,  
Si ai q'u mund dhe ai që fitoi,  
Të mbyllen defterat, të nisë tregtia.

Për tatim-fitimet? S'kemi se ç'të japim.  
Ne jemi myflis, kqyrni dhe qitapin:  
Dalim pér të marrë.  
Ja reform' agrare!  
E ç'i duhet toka bujkut që s'ka fare?  
Do t'bjer' zi e madhe, bukë nuk do t'ketë,  
Blini, fshihni, mibyllni... do t'bëhet qiamet!

Kuçova, minierat, s'ka si shfrytëzohen,  
Kapitalit t'jashtëm do t'i gjunjëzohen.  
Dyqanet e shtetit do t'falimentojnë  
Dhe kooperativat s'ka se si qëndrojnë.

Tharja e Maliqit ësht' budallallëk,  
Duhen kapitale, do kallaballëk,  
Me makinerira, shoqëri të huaj  
Që kilen e ujit me ar ta paguaj....

Hidh e prit parulla, u zu goja lesh  
Duke llomotisur fjalë vesh më vesh.  
Fjalë vesh më vesh e fshehur si minj,  
Punës i ven shkleka disa faqezinj;  
Por fshati që duket nuk do kallaуз,

Gjith' këto parulla u bien në pus.  
Karvani shkon rrugën, qentë rrahin dhëmbët,  
I qajn' hall kalorsit se i varren këmbët.

*Botuar në revistën «Hosteni», Viti I,  
Nr. 13, dt. 23. VI. 1946*

## **IDEALISTËT E KOLLTUKUT E TË PARASE**

Shqipëria një rryp toke anës det',  
Ka patur tej e ndanë salltanet:  
Bejler' e bajraktarë për ibret  
Që rronin me të ndenjur, në kimet.

Tirana për tiranër s'hoqi keq,  
Satrapët si t'i donje, sa për dreq,  
Me mbretër, mëkëmbës të rinj e pleq,  
Që rripnin e sundonin mos më keq!

Dhe populli i tërë ky millet  
Punonte, milingonjë përmbi dhet,  
Për taksa, spekulime dhe ryshfet,  
Q'i hanin k'ta gjakpirës me lezet.

Pa doli më në fund një fshes' e gjatë  
Q'i mblođhi këto plehra me lopatë,  
Ku ishin e ku s'ishin këta veshgjatë  
Që kishin ideal: «Kolltukun dhe paratë».

*Botuar në revistën «Hosteni», Viti II.  
Nr. 19, dt. 28 shtator 1946*

## TE MBJELLIM

(Këngë)

Përpara ju bujq' e fshatarë,  
Përpara sot puna në fushë na pret,  
Të hedhim në tokë një farë,  
Që bimët të rriten si det.

Në sulm e në gara  
Traktorët buçasin,  
E çajnë përpara  
Kulakët pëlcasin.

Të mbjellim mos lem' as pëllëmbë,  
Dhe bimët t'i rritim selvi,  
Sa burri mos duket më këmbë,  
Çdo kokërr të nxjerrë, të nxjerrë kalli.

Refreni — Në sulm e në gara, etj.

Të mbushim hambarët me grurë,  
Dhe bimët e tjera t'i çojmë,  
Atje në fabrika, në furrë,  
Që plaçkë për ne të prodhojn'.

Ref. Në sulm e në gara... etj.

---

(E pabotuar. Shkruar më 1952 dhe është vënë në muzikë nga Kristo Kono. Është kënduar shumë në atë periudhë për demaskimin e kulakëve.)

## SI E DUAM RININE

— Të thashë, shok, të thashë, vëlla,  
Se veshja e çoroditur brirë s'ka.  
— Kostumin do ta qep ashtu si dua,  
Mos m'u përzie ti, punë për mua

— Ashtu!  
Po dije se jetën e zbuluron puna  
E jo guna.  
— E çfarë, të lutem, paskam unë?  
Dua të jem mbi shokët, diçka më shumë.

— Ashtu!  
Të thashë, shok, të thashë, vëlla,  
(Ti kohën e humbet sot badiava),  
Të bësh më tepër punë shoqërore,  
Ndihmo atje ku të vjen ndore.

— Ç'më duhet mua puna e botës,  
— T'i vë së koti gajle kokës,  
Më mirë loz bilardo sa të dua  
A rri në kafene, punë për mua.

-- Ashtu!

Të thashë, shok, të thashë vëlla,  
Të rendësh pas parasë brirë s'ka.

— Ç'të keqe kam të thur lavdira,  
Për vete të kem vetëm të mira,  
Të kem një punë, qoshe rehati,  
Dhe dymbëdhjetë të bjerë sahati,  
Të puñoj vetëm atje ku dua?  
Ç'të lipset ty? Punë për mua.

-- Ashtu!

Të thashë, e përsëris edhe më mirë,  
Mënyra e jetesës nuk ka brirë.  
Ne duam një rini që merr stafetën,  
Ta shpjerë kudo të vërtetën.

## PASQYRA E LËNDES

	Faqe
<b>Parathënje .....</b>	<b>3</b>
 <i>Nga vëllimi Parada e dasmës (1964)</i>	
Majestik i Korçës .....	11
Qyteti i kontrastit .....	14
Ç'na sjell 35-a .....	17
Ç'desha të isha .....	20
Parada e dasmës .....	22
Reklamë tablele .....	25
Paja .....	28
Muhabet sofati .....	31
Katundari në pazar .....	34
Endërr .....	37
Ç'të flas .....	40
Kandidat për deputet .....	43
Katundari në qytet .....	46
Epitafi i revistave .....	49
Kur të hahet haka .....	51

Faqe

Pa gajle, pa halle .....	53
Tituj fisnikërie .....	56
Pér sytë e botës .....	59
Vrahu duhet hedhur .....	61
Ta gënjejmë veten .....	63
Kandidat pér deputet .....	65
Interviewë me doktor kavalierë .....	67
Tablora të jetës .....	70
Plaku dhe i riu .....	72
Po kërkoj ilaq .....	75

*Nga organet e shtypit dhe të pabotuara*

Ne jemi studentë .....	81
Tregtarët dhe fshatarët .....	83
Vesh më vesh .....	85
Idealistët e kolitukut e të parasë .....	88
Të mbjellim .....	90
Si e duam rininë .....	92